



Një në shpirt dhe trup

“Për këtë arsye njeriu do ta lërë babain dhe nënën e do të jetojë bashkë me gruan e vet e të dy do të jenë një trup i vetëm. Secili prej jush le ta dojë gruan e vet porsi vetveten e gruaja le ta nderojë burrin e vet.”
(Ef. 5,31.33)

At. Rikardo E. Façi

Nëse analizojmë në thellësi, na bën përshtypje kur shohim cilësinë e dashurisë së pastër të bashkëshortëve. Prandaj, mund të themi se kjo nënkupton shenjtërinë e dashurisë njerëzore. Është një gëzim i madh kur bashkëshortët bëjnë Sakramentin e Martesës dhe unë si prift, duke qenë dëshmitar në emër të Zotit, i bekoj, i përqafoj dhe i përgëzoj. Vlera e madhe që Zoti i jep martesës dhe jetës së saj të përditshme tregohet në praninë e Jezusit, Marisë dhe Apostujve në dasmën në Kanë. Ajo prani është domethënëse, sepse Shpëtimtari shenjtëron madhështinë e familjes.

Martesa është një sakrament që i bën dy shpirtra një, dy trupa një mish, siç thotë Fjala e Zotit. Ashtu si materiali e Eukaristisë është buka dhe vera, i Pagëzimit është uji, materiali i Sakramentit të martesës është dhëndri dhe nusja. Zoti shenjtëron dhe bekon dashurinë e burrit për gruan e tij dhe atë të gruas për burrin e saj, duke shkrirë jo vetëm shpirtrat e tyre, por edhe trupat e tyre. Askush nuk duhet ta nënvlerësojë këtë mister të madh, siç e quan Shën Pali (Krh. Ef 5,32).

Krijuesi na ka bërë të marrim pjesë në disa karakteristika hyjnore, si inteligjenca, vullneti, dituria dhe aftësia për të dashur; Ai u ka dhënë burrit dhe gruas mundësinë për ta dashur njëri-tjetrin dhe, në të njëjtën kohë, u dha atyre aftësinë e madhe për të gjeneruar jetë me trupat e tyre, duke marrë pjesë në veprën krijuese të Zotit. Në këtë mënyrë, mund të themi se Zoti donte të përdorte martesën në mënyrë që në dashurinë bashkëshortore, bashkëshortët të mund të përjetonin dashurinë e Tij, madje të sillnin krijesa të reja në botë. Kjo na mëson se marrëdhëniet seksuale nuk janë të këqija, as diçka të turpshme, aq më pak janë diçka që mund të nënvlerësohet ose të emërtohet me tallje. Përkundrazi, është një mrekulli e Zotit.

Kënaqësia që ajo sjell është gjithashtu vepra krijuese e Zotit. Gjithçka që jemi thirrur të bëjmë është e ngarkuar me kënaqësi. Të ngrënit është një kënaqësi, si dhe të pish, të flesh, të bësh nevojat tona fiziologjike, të ecësh, të bisedosh me një mik, të shohësh arritjen e një pune të mbaruar, realizimin e një fëmije në kulmin e një faze, të një studimi, të një punë, të arrish objektivin e një projekti apo blerjen e asaj që kishim nevojë. Pjesa më e madhe e asaj që përjetojmë ka kënaqësinë e saj. Kënaqësia është një mrekulli që Zoti krijoi. Problemi është kur qëllimi i kërkuar është vetë kënaqësia. Kush kërkon vetëm kënaqësi në seks bie në fëlligështi; Ai që kërkon kënaqësi duke i trajtuar keq të tjerët bie në hidhërim; kur dikush lartëson shumë unin e tij, ai çohet në mendjemadhësi; ai që kërkon më shumë para sesa duhet, bie në kopraci; ai që në vend që të gëzohet për sukseset e të tjerëve bie në zili; ai që kapet pas “krevatit” bie në përtaci; ai që ha vetëm për kënaqësi, bie në grykësi. Kërkimi i kënaqësisë në vetvete të çon në mëkat, të çon në mungesën e vetëkontrollit të një personi. Problemi i shumë të rinjve është se në kërkim të kënaqësisë bien në rrugë qorre si droga, alkooli, seksi pa angazhim, me të gjitha pasojat negative që kjo sjell. Sa shumë bashkohen si çifte joformale vetëm për kënaqësi, dhe kënaqësia në vetvete nuk është në gjendje të mbajë një marrëdhënie të qëndrueshme!

Në këtë kontekst, duhet të themi se besimi ynë njej gjithçka që është e bukur, bujare dhe e shenjtë në atë që ka krijuar Zoti. Ajo na mëson se qëllimi i jetës sonë nuk duhet të jetë ndjekja egoiste e kënaqësisë, sepse dashuria nënkupton heqje dorë dhe sakrificë. Zoti na ka dashur deri në kryq, dhe siç kemi thënë edhe në raste të tjera, dashuria martesore është gjithashtu një kryq. Për këtë arsye sot, mbretërimi i individualizmit dhe refuzimi i të gjitha fakteve të dhimbshme do të thotë se projektet e martesës dhe familjes së shumë të rinjve përfundojnë në zhgënjim dhe shkatërrim të asaj që ata e quanin "dashuri".

Njerëzit, bashkëshortët, të cilët kujdesen vetëm për veten e tyre, duke kërkuar kënaqësinë e vet, vënë në rrezik lumturinë martesore dhe vetë shpëtimin e tyre, sepse mëkati është i pranishëm. Kështu ndërtohen edhe familje të palumtur dhe të trishtuara. Vetëm ata që harrojnë veten dhe ia dorëzojnë veten Zotit dhe të tjerëve, veçanërisht bashkëshortit të tyre, do të arrijnë gëzimin dhe lumturinë që është një parashijim i parajsës.

Dashuria autentike kërkon drejtësi në të gjitha marrëdhëniet martesore. Siç thamë, Zoti i ka pajisur me kënaqësi funksionet e ndryshme të jetës njerëzore. Prandaj, kënaqësia është e mirë. Por nëse njeriu, duke përmbysur rendin e krijimit, kërkon kënaqësinë si vlerë kryesore, duke përçmuar qëllimin për të cilin është krijuar, ai e çnatyron atë, duke e kthyer në mëkat.

Dlirësia, që është vetëkontroll, që nuk do të thotë vetëm vetëpërmbajtje, por të qenit zotërues i vetes për të jetuar plotësisht me një shpirt i dashuruar, është virtyti që ruan shpirtin rinor të dashurisë bashkëshortore.

Nuk ka dashuri martesore të gëzueshme pa virtytin e dëlirësisë, sepse ai respekton misterin e seksualitetit, i cili gjeneron jetën e fëmijëve dhe, në të njëjtën kohë, shfaq dashurinë që mban familjen. Bashkëshortët nuk duhet të ndalojnë kurrë së shprehuri dashurinë, sepse ajo është baza e jetës familjare. Ajo që Zoti kërkon është që ata të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë reciprokisht besnikë, që të veprojnë me delikatesë, natyrshëm, me modesti. Marrëdhëniet martesore janë të denja kur janë prova e dashurisë së vërtetë.

Kur dëlirësia martesore është e pranishme në dashuri, jeta bashkëshortore është autentike, bashkëshortët e kuptojnë njëri-tjetrin dhe ndihen të bashkuar; kur seksualiteti është i çoroditur, intimiteti shkatërrohet. Kur bashkëshortët e ndërtojnë bashkëjetesën e tyre mbi dashurinë e singertë dhe mbi pranimin e gëzuar të fëmijëve që u ka dhënë Zoti, edhe pse duhet të heqin dorë nga rehatia personale dhe duhet të besojnë në Zotin provanor për të krijuar një familje të bukur, kjo është një garanci e lumturi.

Mrekullia e martesës dhe në të njëjtën kohë sfida e saj e madhe është të zbulosh sesi të dy bashkëshortët bëhen një në shpirt dhe trup.

Lutja

O Zot Jezus, ti na ke thirrur në jetën martesore,
duke na dhënë mundësi të panumërta
për të rritur dhe shfaqur dashurinë tonë,
veçanërisht intimitetin dhe seksualitetin.

Na ndihmo që dhuratat të tu t'i jetojmë gjithmonë
si dorëzimi i plotë i vetes ndaj tjetrit,
duke kërkuar të mirën dhe lumturinë e tij.

Na ndihmo të zbulojmë se çdo gjë që është dashuri autentike
na çon në shenjtërinë e jetës,
të cilën ne fillojmë ta jetojmë këtu
dhe vazhdon me dashurinë tonë në përjetësi. Amen.

Puna Martesore

- 1.- A e kemi zbuluar madhësitinë e asaj që na ka dhënë Zoti në mundësinë e një përqaftimi intim?
- 2.- A kërkojmë të kënaqim bashkëshortin apo ndonjëherë kemi kërkuar të kënaqim veten?
- 3.- A i edukojmë fëmijët në vetëkontroll? A i mësojmë ata të respektojnë njerëzit e seksit tjetër?
- 4.- A zbulojmë dhe ndihmojmë për të zbuluar se në Krijim Zoti krijoi marrëdhënien seksuale dhe në Shëlbim dha mundësinë që ajo të jetë edhe një instrument shenjtërie?

Puna Shtyllë

- 1.- A e kuptojmë se nxitje aktuale i shthurjes seksuale e varfëron personin njerëzor?
- 2.- Çfarë do të thotë të mos vlerësosh vlerën e seksit dhe seksualitetit? A ka mungesë formimi? A kemi marrë formime të gabuara?
- 3.- Si mund t'i ndihmojmë brezat e rinj të kuptojnë vlerën e seksualitetit, martesës dhe familjes, në mes të një shoqërie që kërkon të shkatërrojë të gjitha këto vlera?

4.- Si t'i edukojmë të rinjtë në dëlirësinë, në mënyrë që ata të përgatiten sa më mirë për martesën e tyre të ardhshme?